

# REFORMA E INSPEKTIMEVE

INFORMATA BAZË PËR REFORMËN E INSPEKTIMEVE

KORRIK 2023

## INFORMATA KONTAKTUESE PËR ZIP

 [info.zip@rks-gov.net](mailto:info.zip@rks-gov.net)

 +383 (0) 38 200 14 500

 <https://www.facebook.com/RKSZIP>

 [linkedin.com/company/rkszip](https://www.linkedin.com/company/rkszip)

Mbështetur nga:



Pikëpamjet e shprehura në këtë broshurë nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.



Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm  
Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës


# HYRJE

Reforma e inspektimeve është një ndër reformat kryesore përmes së cilës synohet përmirësimi i mjedisit afarist dhe mbrojtja e interesit publik, duke përfshirë shëndetin publik, sigurinë publike dhe mjedisin. Ligji për Inspektimet i cili ka hyrë në fuqi në shkurt 2022, i përcakton parimet bazë të procedurës së inspektimit si dhe të drejtat dhe detyrimet e inspektorëve dhe subjekteve të inspektuara.

Fushëveprimi i Ligjit për Inspektimet shtrihet në të gjitha funksionet e inspektimit në kompetencë të administratës shtetërore dhe komunave në Republikën e Kosovës, përveç:

1. Inspektimit doganor dhe tatimor;
2. Inspektimit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
3. Inspektimit të brendshëm me karakter administrativ në administratën shtetërore dhe komunale;
4. Inspektimet nga Inspektorati Policor; dhe
5. Inspektimet për siguri publike në kuadër të ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme.

Qëllimi i kësaj fletushke është ofrimi i informatave bazë mbi reformën e inspektimeve siç parashihet në Ligjin për Inspektimet. Harmonizimi i ligjeve sektoriale me Ligjin për Inspektime, proces i cili ka filluar dhe është në vazhdim, kërkohet në mënyrë që reforma të jetë plotësisht e zbatueshme dhe t'u mundësojë qytetarëve dhe bizneseve të realizojnë të drejtat e tyre të plota.



# PARIMET E INSPEKTIMIT

**1. Parimi i transparencës:** Organet inspektuese duhet që t'i ofrojnë publikut informata lehtësisht të përdorshme, gjithëpërfshirëse dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ruajtjen e sekretit afarist.

**2. Parimi i pavarësisë dhe profesionalizmit:** Organet inspektuese dhe inspektorët duhet t'i ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë të pavarur dhe profesionale, të pa ndikuar nga të tjerët.

**3. Parimi i proporcionalitetit:** Inspektorët gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ndërhyjnë në funksionimin e subjektit inspektues vetëm në masën e nevojshme për të siguruar një inspektim efektiv, si dhe i përzgjedhin masat dhe i përcaktojnë afatet më të favorshme në proporcion me peshën e shkeljes dhe pasojat e saj.

**4. Parimi i koordinimit dhe racionalizimit:** Inspektimet duhet të zhvillohen në mënyrë të koordinuar dhe kur është e nevojshme bashkërisht nga organet inspektuese, në mënyrë që të ketë sa më pak dyfishime dhe të sigurohet përdorimi më efektiv dhe efikas i mjeteve publike dhe të minimizohet barra për subjektet e inspektimit.

**5. Parimi i qasjes së bazuar në rrezik:** Inspektimet duhet të planifikohen dhe realizohen sipas qasjes së bazuar në rrezik, duke marrë për bazë shkallën e rrezikut që paraqet veprimtaria e subjektit të inspektimit dhe duke i ndarë subjektet e inspektimit dhe veprimtaritë e tyre në grupe të rrezikut.

**6. Parimi i mbështetjes së subjektit të inspektimit:** Organet inspektuese duhet të ndërmarrin masa aktive për të mbështetur subjektin e inspektimit në sigurimin e pajtueshmërisë me ligjin.

**7. Parimi i mbështetjes në prova:** Inspektimet duhet të bazohen në prova dhe në matje konkrete.

**8. Parimi i planifikimit të inspektimeve:** Subjektet e inspektimit mund të inspektohen vetëm në zbatim të planit të inspektimit.

**9. Parimi i dispozitës më të favorshme ligjore:** Kur dispozitat ligjore, në bazë të cilave zhvillohet inspektimi janë të paqarta apo bien në kundërshtim me njëra-tjetrën, inspektori vepron në mënyrën që cenon më pak subjektin e inspektimit.



# ZYRA E INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM (ZIP)

Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm (ZIP) është agjenci ekzekutive në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e cila udhëhiqet nga Inspektori i Përgjithshëm.

Kjo zyrë e udhëheq reformën e inspektimeve në Republikën e Kosovës dhe koordinon sistemin e inspektimeve brenda administratës shtetërore të nivelit qendror dhe atij komunal.

Në kuadër të kësaj, ZIP i mbështetë tetë inspektorate qendrore që janë të organizuara si agjenci ekzekutive dhe sipas nevojës mund të kenë edhe degë lokale; tri njësi të veçanta inspektuese që funksionojnë si departamente ose si divizione brenda një ministrie, agjencie ekzekutive apo një agjencie rregullatore; si dhe inspektoratet komunale që funksionojnë në kuadër të administratës shtetërore ose nivelit komunal.



# PËRGJEGJËSITË KRYESORE TË ZIP

Disa nga përgjegjësitë kryesore të ZIP janë:

- Udhëheqja e programit të reformës së inspektimeve në Republikën e Kosovës;
- Mbështetja e ministrive përgjegjëse, komunave, agjencive ekzekutive ose agjencive rregullatore për mbikëqyrjen e performancës së organeve inspektuese në kuadër të tyre;
- Përgatitja e raportit të përgjithshëm vjetor mbi inspektimet që zhvillohet nga të gjitha organet inspektuese dhe paraqitja për miratim në Qeverinë e Republikës së Kosovës;
- Komentimi i nismave ligjore dhe nënligjore në fushën e inspektimeve të ndërmarrë nga qeveria sipas parimeve dhe rregullave të përcaktuara në këtë ligj;
- Krijimi dhe mirëmbajtja e platformës së inspektimeve elektronike, e cila shërben për planifikimin dhe koordinimin e inspektimeve, shkëmbimin e informacionit ndërmjet organeve;
- Zhvillimi dhe miratimi i udhëzuesit dhe metodologjisë së përgjithshme për vlerësimin e rrezikut, planifikimin dhe koordinimin e inspektimeve, dokumentimin e aktiviteteve inspektuese dhe raportimin si dhe udhëzimet e përgjithshme për treguesit e performancës për aktivitetet e inspektimit që matin efektivitetin e tyre;
- Koordinimi dhe mbështetja e aktiviteteve të organeve inspektuese me synim përfundimtar zvogëlimin e barrës administrative mbi subjektin e inspektimit, duke përfshirë koordinimin e inspektimeve të përbashkëta në terren nga organet e inspektuese kur Qeveria miraton inspektime tematike.



# INSPEKTORATET QENDRORE

1. Inspektorati Qendror i Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Pylltarisë, në kuadër të ministrisë përgjegjëse për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural.
2. Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut, në kuadër të ministrisë përgjegjëse për industri, ndërmarrësi dhe tregti.
3. Inspektorati Qendror i Arsimit, në kuadër të ministrisë përgjegjëse për arsim, shkencë dhe teknologji.
4. Inspektorati Qendror i Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, në kuadër të ministrisë përgjegjëse për mjedis dhe planifikim hapësinor
5. Inspektorati Qendror i Punës, në kuadër të ministrisë përgjegjëse për punën, financat dhe transferet.
6. Inspektorati Qendror i Trashëgimisë Kulturore, në kuadër të ministrisë përgjegjëse për kulturë, rini dhe sport.

7. Inspektorati Qendror i Transportit, në kuadër të ministrisë përgjegjëse për infrastrukturë.

8. Inspektorati Qendror i Shëndetësisë, në kuadër të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.





# NJËSITË E VEÇANTA INSPEKTUESE

1. Njësia e Inspektimit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore.

2. Njësia e Inspektimit të Energjisë, në kuadër të ministrisë përgjegjëse për zhvillim ekonomik.

3. Njësia e Inspektimit për Mbrojtjen nga Zjarri, në agjencinë e menaxhimit të emergjencave nën ministrinë përgjegjëse për punët e brendshme.

# INSPEKTORATET KOMUNALE

Organizimi i inspektorateve komunale bëhet sipas dispozitave të ligjeve sektoriale dhe Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Ndërkaq procedurat e inspektimit të inspektorateve komunale rregullohen me Ligjin për Inspektime.



# LLOJET E INSPEKTIMIT

**Inspektimi i planifikuar** është formë e rregullt e inspektimit i bazuar në planin e inspektimit të miratuar paraprakisht nga inspektorati përkatës. Karakteristikat e këtij lloji të inspektimit janë si në vijim:

- Inspektimet planifikohen në pajtim me qasjen e bazuar në rrezik;
- Inspektimet e planifikuara miratohen në baza periodike (tremujore, mujore, javore, etj);
- Planet publikohen në ueb faqen e ZIP dhe organit përkatës inspektues.

**Inspektimi i paplanifikuar** është formë e veçantë e inspektimit i cili mund të realizohet vetëm në këto raste:

- Kur ekziston dyshimi i bazuar se ka ndodhur shkelje substanciale e ligjit ose ka rrezik për interesin publik, duke përfshirë shëndetin publik, sigurinë publike dhe mjedisin;
- Kur ka ndodhur një fatkeqësi ose dëmtim serioz;
- Kur ka ankesë të bazuar që tregon shkelje substanciale që përbën rrezik për interesin publik, duke përfshirë shëndetin publik, sigurinë publike dhe mjedisin; ose
- Kur ka kërkesë të organeve gjyqësore, policore ose organeve tjera përkatëse.





# LLOJET E INSPEKTIMIT

**Inspektimi sipas parashtresës** është formë e inspektimit që realizohet me rastin e pranimit të ndonjë parashtrese nga personi fizik apo juridik që vënë në dijeni inspektoratin për shkelje të dispozitave ligjore nga ana e ndonjë subjekti qoftë personi fizik apo juridik.

**Ri-inspektimi** realizohet në rastet kur synohet verifikimi i korigjimit të shkeljeve të gjetura në një inspektim të mëparshëm, si dhe kufizohet vetëm në shkeljet dhe detyrat e dhëna në procesverbalin e inspektimit të fundit.

**Inspektimi i përbashkët** është formë e inspektimit që mbështetet në parimin e koordinimit dhe racionalizimit të inspektimit, që realizohet përmes inspektimit të përbashkët të më shumë inspektorateve përkatëse nga fushëveprimi i tyre në një subjekt të inspektimit.

# PROCEDURA E INSPEKTIMIT

Inspektimi përkufizohet si çdo formë kontrolli apo mbikëqyrjeje nga një organ publik ndaj veprimtarive tregtare, ekonomike, profesionale apo veprimtarive të tjera të personave fizikë apo juridikë, privat apo publikë, që synon mbrojtjen e interesit publik, duke përfshirë atë të shëndetit publik, sigurisë publike dhe mjedisit në ushtrimin e këtyre veprimtarive në pajtim me kërkesat e detyrueshme të përcaktuara në legjislacionin e Republikës së Kosovës. Procedura e rregullt e inspektimit përfshinë hapat si në vijim:


1. Miratohet inspektimi nga udhëheqësi i organit përkatës inspektues;
2. Njoftohet subjekti i inspektimit që do të inspektohet jo më pak se tri ditë para inspektimit;
3. Zhvillohet inspektimi në bazë të listës së kontrollit;
4. Hartohet procesverbali dhe dëgjohet subjekti (aty për aty);
5. Merret vendimi dhe nënshkruhet procesverbali (aty për aty).



# TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË INSPEKTUAR

Disa nga të drejtat kryesore të subjektit të inspektuar të përcaktuara në Ligjin për Inspektimet janë:

- Të kërkojë të njoftohet me miratimin e inspektimit para fillimit të inspektimit përveç rasteve kur sipas ligjit, inspektimi nuk bëhet në bazë të miratimit paraprak;
- Të kërkojë identifikimin e inspektorëve si dhe të refuzojë pjesëmarrjen e personave të paautorizuar;
- Të jetë i pranishëm dhe të përcjellë, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar me shkrim, të gjitha veprimet e inspektimit;
- Të ushtrojë ankesë kundër vendimit të inspektorit sipas legjislacionit në fuqi;
- Të kërkojë dhe të marrë informacion nga inspektori për procedurën e inspektimit dhe për çdo veprim apo vendim të ndërmarrë gjatë saj;
- Të kërkojë kopjen e procesverbalit të inspektimit dhe të jep vërejtje nëse nuk pajtohet me konstatimet e paraqitura aty;
- Të paraqesë, me shkrim apo me gojë, mendimet, shpjegimet për faktet, rrethanat apo edhe për çështjet ligjore, që kanë të bëjnë me inspektimin, apo të paraqesë propozimet e tij për zgjidhjen e çështjes dhe dokumentet përkatëse ku i mbështet ato;
- Të kërkojë kopjen e listës së kontrollit sipas së cilës është kryer inspektimi.



# DETYRIMET E SUBJEKTIT TË INSPEKTUAR

Disa nga detyrimet kryesore të subjektit të inspektuar të përcaktuara në Ligjin për Inspektimet janë:

- T'i mundësojë dhe sigurojë inspektorit kushte të nevojshme për kryerjen e pa penguar të procedurës së inspektimit;
- Të bashkëpunojë me inspektorin, të mos e pengojë në kryerjen e veprimeve të inspektimit, të kryejë veprime sipas urdhrit të inspektorit;
- T'i mundësojë inspektoratit qasje në hapësirat punuese, dokumentet dhe pajisjet që janë objekt i inspektimit;
- T'i ofrojë inspektoratit të dhëna, dokumente dhe materiale tjera, të sakta dhe brenda afatit të përcaktuar nga inspektori;
- Me kërkesë të inspektorit, ta ndalë punën gjatë kohës së inspektimit, kur inspektori nuk mund ta kryej inspektimin;

- Të kryejë veprime gjatë procedurës së inspektimit, për të vlerësuar gjendjen faktike, të lejojë dhe të mundësojë marrjen e dëshmive nga punonjësit e tij, nëse kjo kërkohet nga inspektorët;
- Me kërkesë të inspektorit, dhe brenda afatit të caktuar, t'i dorëzojë ose përgatitë të dhëna, raporte, materiale dhe dokumente tjera të nevojshme për procedurën e inspektimit;
- Brenda afatit ligjor, pas përfundimit të afatit të caktuar për zbatimin e masave të urdhëruara, që me shkrim të informojë inspektorin se a janë zbatuar masat e urdhëruara.






# TË DREJTAT E INSPEKTORIT

Disa nga të drejtat kryesore të inspektorit të përcaktuara në Ligjin për Inspektimet janë:

- Të hyjë lirisht në çdo vend dhe të inspektojë ndërtesat, mjediset, objektet, mjetet e transportit, në të cilat ose përmes së cilave ushtron veprimtarinë e tij subjekti i inspektimit, si dhe të inspektojë instalimet, pajisjet, makineritë, produktet, gjësendet, substancat, përbërësit dhe çdo send tjetër të lidhur me veprimtarinë që është objekt i inspektimit;
- Të inspektojë instalimet, makineritë, produktet, substancat, përbërësit dhe çdo send tjetër të lidhur me veprimtarinë që inspektohet;
- Të bëjë fotografime, filmime të mjediseve, instalimeve, proceseve të punës dhe objekteve për qëllime të inspektimit;
- Të marrë pa pagesë, mostra të produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve për qëllime të inspektimit;
- Të kërkojë dokumentin e identifikimit personave të cilët janë prezent me rastin e inspektimit;
- Të sanksionojë subjektin kur konstaton se ka shkelje si dhe të inicioj procedurë kundërvajtëse dhe penale;
- Të kërkojë nga subjekti inspektues ose personi përgjegjës sqarime, raporte me shkrim në lidhje me çështjet e inspektimit.



# DETYRIMET E INSPEKTORIT

Disa nga detyrimet kryesore të inspektorit të përcaktuara në Ligjin për Inspektimet janë:

- Të njoftoj subjektin e inspektimit për miratimin e inspektimit, jo më pak se tri (3) ditë kalendarike para fillimit të veprimeve të inspektimit;
- T'i përmbushë detyrat e tij në mënyrë të pavarur dhe profesionale;
- Të legjitimohet para subjektit dhe e njofton për bazën ligjore për ushtrimin e kontrollit dhe inspektimit;
- Të ofron këshilla dhe informata të nevojshme subjekteve të inspektimit për zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore;
- Të informojë parashtruesin e ankesës për rrjedhën e procedurës së inspektimit në afatin e përcaktuar me ligj;
- Të mos ketë ndonjë konflikt interesi me subjektin e inspektimit në kuadër të kompetencave të inspektimit;

- Të ruajë në konfidencë të plotë burimin e ndonjë parashtrësë që atyre u është paraqitur në lidhje me ndonjë veprim që ka të bëjë me shkeljen e ligjit;
- Të mbaj procesverbal dhe në fund të hartojë raport për gjendjen faktike të subjektit të inspektuar.



# PROCEDURA E ANKESËS

Në rast se subjekti i inspektuar nuk pajtohet me një vendim përfundimtar të inspektimit, ai mund të paraqes ankesë ndaj atij vendimi brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e njoftimit me vendimin përfundimtar.

Ankesa paraqitet dhe shqyrtohet nga organi përkatës epror, i cili ndryshon në varësi të llojit të inspektoratit. Për inspektoratet qendrore, një organ kolegjal i krijuar nga ministri është përgjegjës për shqyrtimin. Për inspektoratet komunale organi krijohet nga kryetari i komunës, kurse në rastin e njësive të veçanta të inspektimit që janë pjesë e një ministrie ose agjencie ekzekutive, një organ kolegjal i krijuar nga ministri ose drejtuesi i agjencisë është përgjegjës për shqyrtim.

Ankesa trajtohet në përputhje me Ligjin për Inspektimet dhe ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.

